



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 6961 prot.

Shkodër, më 01.04. 2025

Lënda: Dërgim relacioni dhe projekt-vendimi

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR


Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

“PËR DHËNIEN E TË DREJTËS DHE CAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË MENAXHIMIT, ADMINISTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PLAZHEVE PUBLIKE TË MENAXHUESHME PËR SHOQËRINË AKSIONERE, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR ME NIPT M369240030.

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,



Relacion: 3 faqe
Pr/Vendim: 1 faqe

Nr. Kopje: 4 Kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 6961/prot
11

Shkodër, më 01.04.2025

PROJEKT - VENDIM


Nr. _____, datë _____.____.2025

**“PËR DHËNIEN E TË DREJTËS DHE CAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
MENAXHIMIT, ADMINISTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PLAZHEVE PUBLIKE
TË MENAXHUESHME PËR SHOQËRINË AKSIONERE, NË PRONËSI TË BASHKISË
SHKODËR ME NIPT M36924003O.**

Në mbështetje të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar;;Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji nr.93/2015”Për Turizmin”i ndryshuar; VKM Nr.649,datë 16.10.2024”Për Miratimin e Rregullores”Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”, neni 4; VKB nr. 15 datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca sh.a, si person juridik në pronësi të bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____.prot, datë _____ të administratës së bashkisë Shkodër, me propozim të kryetarit të bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Të miratojë dhëniën e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme, sipas VKM-së nr. 649,datë 16.10.2024, shoqërisë aksionere me NIPT M36924003O.
2. Afati për të cilën i jepet e drejta dhe i caktohet kjo përgjegjësi do të jetë 5 (pesë) vjet, sipas hartës së azhornuar ndër vite.
3. Shoqëria Aksionere me NIPT M36924003O do t’a ushtrojë këtë veprimtari sipas kriterëve dhe përcaktimeve ligjore në fuqi.
4. Shoqëria Aksionere me NIPT M36924003O nuk ka të drejtë t’ja japë këtë hapësirë me qira të tretëve apo t’a shfrytëzojë bashkërisht me operatorë të tjerë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
6. Ky vendim Hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



Zv. Kryetar

Alban Preke

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Arbana Mushi

Drejtoria e Juridike

[Signature]

Drejtoria e aseteve dhe kadastrës urbane

Serena Mujetli

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Bekim Nana

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Jonis Xekshaj

Drejtoria e Turizmit

Renato Dumçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM EKONOMIK
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRËS URBANE
DREJTORIA E TURIZMIT

Nr. _____ prot

Shkodër, më ____ . ____ .2025

RELACION

“PËR DHËNIEN E TË DREJTËS DHE CAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË MENAXHIMIT, ADMINISTRIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË PLAZHEVE PUBLIKE TË MENAXHUESHME PËR SHOQËRINË AKSIONERE, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR ME NIPT M369240030.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar këshilltarë!

Plazhi i Velipojës, me shtrirje rreth 14 km linear, është një nga destinacionet më të rëndësishme turistike për Bashkinë Shkodër, duke ofruar mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë lokale. Me kapacitetin e lartë akomodues, që përfshin rreth 226 hotele, 3,658 dhoma dhe 11,549 shtretër, ky plazh ka një fluks të lartë pushuesish ditorë dhe sezone turistike të ngarkuara. Kjo e bën plazhin një nga më të frekuentuarit në Shqipëri, duke rritur kërkesën për shërbime cilësore dhe me çmime konkurruese.

Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër ka një përgjegjësi të madhe për të siguruar shërbimet e nevojshme për pushuesit, duke përfshirë administrimin dhe menaxhimin e hapësirave publike të menaxhueshme të plazhit dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për pushuesit.

Duke qënë se plazhi i Velipojës është një nga plazhet më të frekuentuara në Shqipëri, me një numër të lartë pushuesish, për bashkinë Shkodër është me shumë rëndësi ofrimi i shërbimeve të duhura për këto pushues me çmime konkurruese dhe të përballeshme nga publiku.

Sipas përcaktimit të nenit 4, pika 3 të VKM nr.649, datë 16.10.2024, ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar publik/privat do të kryhet sipas rregullit që për çdo 1000 m vije lineare 300 m të përcaktohen si parcela publike ndërsa pjesa tjetër të jetë në menaxhim privat. Kjo pjesë e **hapësirës publike e plazhit mbetet për qytetarët për përdorim pa pagesë.**

Me ndryshimet përkatëse ligjore dhe evidencat e deritanishme për numrin e aplikimeve dhe operatorëve të interesuar që plotësojnë kriteret për marrje në administrim të parcelave private të plazheve, Bashkia Shkodër do të ketë në dispozicion, përveç sipërfaqes së plazheve publike, pa pagesë, edhe hapësira plazhi të cilat në zbatim të nenit 4 pika 6 e VKM nr.649, datë 16.10.2024 do të administrohen/menaxhohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke siguruar kushtet e

përshtatshme e standarde për pushuesit që duan të kenë shërbime shtesë nga ajo që ofron plazhi i lirë publik.

Për ofrimin e një shërbimi sa më të mirë ndaj pushuesve të shumtë të plazhit Velipojë është e nevojshme që të kemi një strukturë, pjesë e bashkisë Shkodër, e cila menaxhon dhe administron këto hapësira plazhi në mënyrë të njëjtë me ofertën ekzistuese në treg duke ofruar shërbim të mirë për pushuesit, në të gjitha hapësirat që do të jenë të disponueshme.

Për këtë qëllim, Bashkia propozon të ofrojë një strukturë menaxhuese publike që do të administrojë/menaxhojë të gjitha hapësirat e plazhit publik të menaxhueshëm në mënyrë të unifikuar dhe të organizuar, duke siguruar shërbime të njëjta dhe standarde në çdo pjesë të plazhit. Vendosja e çadrave, shezlonëve, rampat e aksesit e të tjera facilitete që krijojnë kushtet e përshtatshme për pushuesit janë të gjitha element që duhen menaxhuar dhe administruar për të bërë sa më funksionale ofrimin e shërbimit ndaj pushuesve.

Disa elemente kyçe për të menaxhuar dhe administruar këto hapësira plazhi do të përfshijnë:

Vendosjen e Cadrave dhe Shezlonëve:

Të ofrohen hapësira të përshtatshme për relaksim dhe pushim për pushuesit, duke siguruar gjithashtu komoditet dhe mbrojtje nga dielli.

Rampat e Aksesit dhe Facilitete të Përshtatshme:

Përshtatje e plazhit për të gjithë pushuesit, duke siguruar rampa dhe infrastrukturë që mundësojnë akses të lehtë për të gjithë.

Sigurimi i Shërbimeve Higjienike dhe të Sigurisë:

Të krijohen kushte të përshtatshme higjienike dhe shërbime të sigurisë për pushuesit, duke i ofruar ata me informacion të nevojshëm për sigurinë në plazh dhe kushte komode për përdorim.

Menaxhimi i Të Ardhurave dhe Investimeve:

Me menaxhimin e këtyre hapësirave, të ardhurat që gjenerohen do të përdoren për përmirësimin e infrastrukturës së plazhit dhe për shtimin e sipërfaqeve të menaxhuara nga Bashkia, duke siguruar rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe shtrirjen e hapësirave publike.

Ky plan do të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në Velipojë, duke përmirësuar shërbimet për pushuesit dhe duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Bashkisë Shkodër si dhe përmirësimin e ofertës turistike duke krijuar mundësi për të ofruar një plazh të sigurt, të pastruar dhe me shërbime cilësore.

Duke qëne se sezoni turistik i shfrytëzimit të plazhit Velipojë po afron është me shumë rëndësi që të përcaktohen dhe fillohet puna sa i përket strukturës menaxhuese të këtyre hapësirave publike të cilat do të jenë në funksion të pushuesve. Bashkia Shkodër ka në pronësi të saj 100% sh.a. me NIPT M369240030, e cila me rritjen e kapaciteteve të saj mund të operojë në ushtrimin e funksionit të menaxhimit dhe administrimit të këtyre hapësirave të plazhit.

Për këtë arsye përmes këtij relacioni në mbështetje të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligjit nr.93/2015”Për Turizmin”i ndryshuar; VKM Nr.649, datë 16.10.2024”Për Miratimin e Rregullores”Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”; VKB nr.15 datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca

sh.a, si person juridik në pronësi të bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”, propozojmë që:

Plazhet publike të menaxhueshme për të cilat nuk janë lidhur kontratat e qirasë për përdorimin e stacionit të plazheve, deri në afatin përcaktuar në nenin 4, pika 5 të VKM-së nr. 649, datë 16.10.2024, të administrohen, menaxhohen dhe mirëmbahen nga Shoqëria Aksionere me NIPT M36924003O duke krijuar kushtet e përshtatshme për ofrimin e shërbimit ndaj pushuesve sipas përcaktimeve ligjore.

Sh.a. me NIPT M36924003O do të krijojë të gjitha kushtet e përshtatshme për sigurim të aksesit të publikut në shërbimet e ofruara nga një hapësirë plazhi si vendosja e shezlonëve, çadrave, rampave të aksesit etj.

Afati për të cilën i jepet e drejta dhe i caktohet kjo përgjegjësi do të jetë 5 (pesë) vjet, sipas hartës së azhornuar ndër vite.

Sh.a. me NIPT M36924003O do të ketë përgjegjësinë e administrimit menaxhimit, mirëmbajtjes dhe ofrimit të këtyre shërbimeve në plazhet për të cilat nuk është lidhur kontrata me operator privat deri në datën e përcaktuar nga aktet nënligjore në fuqi të cilat funksionojnë si plazhe publike të menaxhuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Shoqëria Aksionere me NIPT M36924003O nuk ka të drejtë t’ja japë këtë hapësirë me qira të tretëve apo t’a shfrytëzojë bashkërisht me operatorë të tjerë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të
Qëndrueshëm Ekonomik

Zekir Neme

Drejtorja e Turizmit

Renat Durmazi

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të
Territorit

Dulcem Ilorhi

Drejtorja e Aseteve dhe Kadastrës Urbane

Senene Mijesthi



KRYETARI
Benet BECI